



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PA1.nr.969/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm - në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Shqipe Qerimi - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Ahmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.A., nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale Dhuna në familje, nga neni 248 par.2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit B.A. – av. Teuta Zhinipotoku të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1578/2020, datë 07.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së, me datë 23.11.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me **aprovimin** e ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit B.A. – av. Teuta Zhinipotoku **ndryshohet**, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1578/2020, datë 07.09.2020, vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarit B.A., për veprën penale Dhuna në familje, nga neni 248 par.2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), e për të cilën është shpallur fajtor, kjo Gjykatë e gjykon me dënim me burg në kohëzgjatje prej 83 (tetëdhjetë e tre) ditë. Aktgjykimi në pjesët tjera ngel i pandryshuar.

Të akuzuarit B.A., me aktvendim të veçantë i është **ndërprerë** masa e paraburgimit me datë 23.11.2020.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.1578/20, të datës 07.09.2020, të akuzuarin B.A., për shkak të veprës penale Dhuna në familje, nga neni 248 par.2 lidhur me par. 1

të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me burgim dhe me gjobë, ashtu që i vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, të cilin dënim do ta vuajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 100 e (njëqind euro), të cilin dënim do ta paguajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet konform nenit 43 par. 3 gjykata mund ta zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke i llogaritur 20 € (njëzet euro) të gjobës për një ditë burgim. I akuzuari është detyruar që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 € (tridhjetë euro) dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej 30 € (tridhjetë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Me aktvendim të veçantë të datës 07.09.2020, P.nr.1578/20, të akuzuarit i është vazhduar masa e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar sipas aktgjykimit të kësaj gjykate. E dëmtuara ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar :

Mbrojtësja e të akuzuarit B.A. – Teuta Zhinipotoku, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, ashtu që për të akuzuarin duke aplikuar dispozitat mbi zbutjen e dënimin t'ia zbutë dënimin ashtu që t'ia zëvendësojë me dënim me gjobë, ose aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtrësën PPA/II.nr.982/2020, datë 05.11.2020 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së, caktoi seancën e kolegjit, për të cilën me kohë dhe në mënyrë të rregullt njoftoi palët. Në seancë prezantuan e dëmtuara B.A., e cila deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike. Mbrojtësja e të akuzuarit av. Teuta Zhinipotoku, deklaroi se mbetet në tërësi pranë ankesës së ushtruar dhe propozimit në të, shtoi se dënimi është i lartë dhe meqenëse i mbrojturi i tij veçse ka mbajtur gjysmën e dënimit theksoi se kërkon që të akuzuarit pjesa e mbetur e dënimit me burg ti falet dhe i njëjti të lirohet. I akuzuari B.A., deklaroi se e mbështet ankesën dhe fjalën e mbrojtëses së tij dhe premtoi se më nuk do të përsërisë vepra penale. Në seancë edhe pse i njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt, nuk prezantoi dhe nuk mori pjesë Prokurori.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesa gjeti se:

Ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e

shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit, e të cilat do kishin kushtëzuar anulimin e tij

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Mbrojtësja e të akuzuarit e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke pretenduar që lartësia e sanksionit penal të shqiptuar për të akuzuarin është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Mbrojtësja e të akuzuarit në ankesë thekson që fakti që gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë si rrethanë rënduese faktin se i akuzuari ka qenë edhe më parë i dënuar nuk qëndron, ngase i njëjti asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar e as që është zhvilluar procedurë penale ndaj tij për veprën penale dhunë në familje. Tutje në ankesë potencohet, se gjykata e shkallës së parë ka dështuar që të marrë parasysh rrethanat tjera lehtësuese të cilat do ndikonin në marrjen e një sanksioni më të butë, duke përfshirë këtu gjendjen ekonomike të familjes së rënduar ngase i akuzuari është mbajtës i familjes, e po ashtu edhe faktin që e dëmtuara në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se nuk ka frikë dhe mendon se i akuzuari do të përmirësohet, e njëjta dëshiron që përsëri ti vendos raportet e mira bashkëshortore me të akuzuarin, dëshiron ti kthehet jetës normale dhe të qetë bashkë me burrin dhe fëmijët e tyre, si dhe faktin se e njëjta po ashtu ka vizituar të akuzuarin në qendrën e paraburgimit, i kanë rivendosur raportet e mira mes vete, e gjithashtu duke pas parasysh sjelljet e të akuzuarit gjatë gjithë zhvillimit të procedurës. Sipas pretendimeve të mbrojtëses së të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë është dashur që të akuzuarit mos ti shqiptoj dënim me burg, por t'ia zëvendësoj atë me dënim me gjobë, pasi që bazë të dispozitës së nenit 248 par. 3 lidhur me par. 1 parashihet mundësia që në rastet e tilla kur nuk është paraparë minimumi i dënimit, atëherë dënimi me burg mund të zëvendësohet me gjobë (e aq më tepër kur ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese). Prandaj, në ankesë konsiderohet që dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është dënim i rëndë, jo në korrelacion me gjendjen faktike, i padrejtë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, është penduar thellë për veprën që ka bërë dhe ka premtuar që asnjëherë nuk do të përsërisë më vepra. Për më tepër, e dëmtuara nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, nuk ndjehet e frikësuar, është e gatshme të vazhdoj jetën pranë bashkëshortit të saj, e po ashtu e njëjta beson se i akuzuari do të përmirësohet. Andaj, mbrojtësja e të akuzuarit propozon që me zëvendësimin e dënimit me burg, në atë me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit. Po ashtu në seancë propozon që të mbrojturit të saj pjesa e mbetur e dënimit me burg të i falet dhe i njëjti të lirohet nga paraburgimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e më sipërme ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit për një dënim më të butë, janë të bazuara. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 69 dhe nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethanë

lehtësuese për të akuzuarin ka marrë faktin e pranimit të fajësisë, se është mbajtesë i familjes, baba i dy fëmijëve, ndërsa rrethana rënduese mori faktin se i akuzuari ishte i dënuar edhe më parë dhe në prezencë të këtyre rrethanave të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjyqimit të ankimuar me bindjen se edhe me këtë dënim do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një konstatim të tillë të rrethanave lehtësuese e pranon edhe kjo gjykatë, mirëpo kjo gjykatë vlerëson se në prani të këtyre rrethanave ka vend për shqiptimin e një dënimi më të butë nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë. Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, si dhe duke marrë për bazë si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin e tij për veprën e kryer, kërkim faljen publike të dëmtuarës, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla të ngjashme, pastaj faktin se e dëmtuara nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, nuk kërkon dëmshpërblim, si dhe gatishmërinë e saj për të vazhduar jetën bashkëshortore, e në mungesë të rrethanave rënduese pasi që nuk mund të trajtohet si rrethanë rënduese ashtu siç e ka konstatuar gjykata e shkallës së parë ‘se ishte i dënuar edhe më parë’, në mungesë të aktgjyqimit të theksimit të aktgjyqimit të plotfuqishëm, të numrit të aktgjyqimit dhe datës së plotfuqishmërisë. Andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kësaj gjykate paraqesin rrethana veçanërisht lehtësuese dhe arsyetojnë shqiptimin e një dënimi më të butë, ngase kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë me aktgjyqimin e ankimuar është i ashpër, për çka aktgjyqimin e ankimuar e ndryshoj dhe të akuzuarit i shqiptoj dënim tani më të butë sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se i njëjti është në harmoni të plotë me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim është në funksion të preventivës gjenerale si dhe asaj individuale dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale. Kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga kjo gjykatë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 38 të KPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti i Përgjithshëm

PA1.nr.969/20, më datë 23.11.2020

Bashkëpunëtori profesional,

Bujar Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani

Kryetar i kolegjit,

Hashim Çollaku

Shqipe Qerimi